

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
1.	20.1.2023	Kërkesë për informacion nga E.B se kur hapen aplikimet për punë?	24.01.2023	Garda e Republikës shpall periodikisht vende të lira pune. Ju duhet të ndiqni njoftimet në faqen zyrtare www.garda.gov.al dhe të aplikoni sipas afateve kur të shpallen vendet e lira për të marrë pjesë në konkurrim.	E plotë	Nuk ka
2.	30.1.2023	Kërkesë nga shtetasi A.C për të aplikuar përsëri për punë.	03.02.2023	Garda e Republikës shpall periodikisht vende të lira pune. Ju duhet të ndiqni njoftimet në faqen zyrtare www.garda.gov.al dhe të aplikoni sipas afateve kur të shpallen vendet e lira për të marrë pjesë në konkurrim.	E plotë	Nuk ka
3.	27.02.2023	Kërkesë për informacion nga A.B, për të aplikuar për punë në Gardën e Republikës.	27.02.2023	“Në referim të Kodit Zgjedhor punësimet në Gardën e Republikës janë pezulluar përkohësisht. Aplikimet rifillojnë në datën 15 Maj e në vijim.”	E plotë	Nuk ka
4.	15.03.2023	Kërkesë për informacion nga A.K nëse do të ketë njoftime për pranimet e aplikantëve.	15.03.2023	“Kërkesa juaj është administruar në regjistrin e kërkesave për punësim. Ju do të njoftoheni kur të shpallet konkurrimi për vende të lira pune.”	E plotë	Nuk ka
5.	16.03.2023	Kërkesë nga shtetasi A.C, nëse është i mundur rikthimi në Gardën e Republikës?	21.03.2023	“Në referim të Kodit Zgjedhor punësimet në Gardën e Republikës janë pezulluar përkohësisht. Aplikimet rifillojnë në datën 15 Maj e në vijim.”	E plotë	Nuk ka
6.	18.03.2023	Kërkesë nga shtetasi O.S për të aplikuar për punë.	20.03.2023	Garda e Republikës shpall periodikisht vende të lira pune, mes të cilëve edhe për ish ushtarak si ju. Ju duhet të ndiqni njoftimet në web: www.garda.gov.al dhe të aplikoni sipas afateve kur të shpallen vendet e lira për të marrë pjesë në konkurrim.	E plotë	Nuk ka
7.	04.04.2023	Kërkesë nga shtetasi A.C për të riaplikuar përsëri për punë.	04.04.2023	Ju bëjmë me dije se, ju u pranuat në Gardën e Republikës dhe e refuzuat ta merrni si	E plotë	Nuk ka

1.Data e regjistrimit të kërkesës

2.Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

3.Data e kthimit të përgjigjes

4.Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

5.Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

6.Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
				detyrë. Në këto kushte, e shohim të pamundur rikthimin tuaj.		
8.	10.04.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi M.B për të bërë rezervimin e Pallatit të Brigadave, për të bërë foto dhe videoklipin e martesës.	14.04.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju vëmë në dijeni se: Garda e Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin 33/2021 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë" dhe akteve nënligjore që normojnë veprimtarinë e saj ruan e siguron Pallatin e Brigadave por nuk është organi që administron këtë objekt. Në lidhje me interesin tuaj, sugjerojmë t'i drejtoheni me kërkesë Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare	E plotë	Nuk ka
9.	11.04.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi R.N, për të aplikuar për punë në Gardën e Republikës	12.04.2023	<p>Punësimi në Gardën e Republikës bëhet bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 33/2021 "PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i cili në nenin 21 përcakton:</p> <p>Neni 21 Kriteret e pranimit</p> <p>1. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasit në Gardë janë:</p> <p>a) të jetë shtetas shqiptar;</p> <p>b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;</p> <p>c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;</p> <p>ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm;</p> <p>d) të jetë i moshës 19-30 vjeç;</p> <p>dh) të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që, sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë;</p> <p>e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi a kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;</p> <p>ë) të mos jetë në ndjekje penale;</p> <p>f) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore;</p> <p>g) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike vendim gjyqësor të formës së prerë.</p> <p>2. Në nivelin bazë, shtetasi pranohet si</p>	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
				<p>punonjës i Gardës së Republikës, kur, krahas plotësimit të kriterëve të përgjithshme, ka përfunduar edhe arsimimin për rolin bazë për punonjës të Gardës në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.</p> <p>3. Bazuar në nevojat e identifikuara për rekrutimin e punonjësve të nivelit të mesëm, në Gardën e Republikës pranohen edhe shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Pas përfundimit të kursit të formimit profesional, u jepet grada “nënkomisar”.</p> <p>4. Pranohet si punonjës i Gardës së Republikës edhe shtetasi që ka përfunduar arsimin përkatës në institucionet arsimore homologe jashtë vendit të njësuara me programet e institucionit arsimor të Policisë së Shtetit, Xhandarmërisë, Karabinierisë, Gardës Civile strukturave të tjera të njësuara me to dhe që diplomat e tyre janë njohur dhe ekuivalentuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>5. Të gjithë kandidatët fitues, pas emërimit në detyrë, ndjekin programin e profilizimit të përcaktuar në politikat e arsimimit të Gardës së Republikës. Për kohën e aplikimit duhet të ndiqni njoftimet në faqen zyrtare të gardës www.garda.gov.al</p>		
10.	14.04.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi K.D , nëse janë shpallur vende vakante dhe nëse jo kur mund të rihapen aplikimet?	24.04.2023	Për tu pranuar në Gardën e Republikës duhet të nënshtroheni konkurrencës dhe më pas kursit në Akademinë e Sigurisë. Kjo ndodh kur të shpallet njoftimi për vende të lira pune. Aktualisht nuk kemi njoftuar për aplikime. Për njoftime ndiqni faqen e internetit www.garda.gov.al	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
11.	19.04.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi B.C për të ditur se cfarë hapash, duhet të ndjek për të aplikuar për punë në Gardë.	19.04.2023	<p>Punësimi në Gardën e Republikës bëhet bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 33/2021 "PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i cili në nenin 21 përcakton:</p> <p>Kriteret e pranimit</p> <p>1. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasit në Gardë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) të jetë shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë; ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm; d) të jetë i moshës 19-30 vjeç; dh) të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që, sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë; e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi a kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje; ë) të mos jetë në ndjekje penale; f) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore; g) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike vendim gjyqësor të formës së prerë. <p>2. Në nivelin bazë, shtetasi pranohet si punonjës i Gardës së Republikës, kur, krahas plotësimit të kriterëve të përgjithshme, ka përfunduar edhe arsimimin për rolin bazë për punonjës të Gardës në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.</p> <p>3. Bazuar në nevojat e identifikuara për rekrutimin e punonjësve të nivelit të mesëm, në Gardën e Republikës pranohen edhe shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që plotësojnë</p>	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
				<p>kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Pas përfundimit të kursit të formimit profesional, u jepet grada “nënkomisar”.</p> <p>4. Pranohet si punonjës i Gardës së Republikës edhe shtetasi që ka përfunduar arsimin përkatës në institucionet arsimore homologe jashtë vendit të njësuar me programet e institucionit arsimor të Policisë së Shtetit, Xhandarmërisë, Karabinierisë, Gardës Civile strukturave të tjera të njësuar me to dhe që diplomat e tyre janë njohur dhe ekuivalentuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>5. Të gjithë kandidatët fitues, pas emërimit në detyrë, ndjekin programin e profilizimit të përcaktuar në politikat e arsimit të Gardës së Republikës.</p> <p>Për kohën e aplikimit duhet të ndiqni njoftimet në faqen zyrtare të gardës www.garda.gov.al</p>		
12.	01.05.2023 (deleguar më 15.06.2023)	Kërkesë për informacion zyrtar nga shtetasi H.M, mbi arsyen pse nuk është pranuar për tu bërë pjesë e Gardës.	19.06.2023 dhe 28.06.2023	I nderuar Z. M*. Në përgjigje të kërkesës suaj drejtuar me e-mail, lidhur me arsyen e mospranimit tuaj, për punësim në Gardën e Republikës ju bëjmë me dije se, sikurse ju kemi njoftuar edhe në takimin që keni pasur në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në datën 26.04.2023, ju nuk përmbushni kriteret ligjore për punësim dhe konkretisht, refuzimi i kërkesës tuaj lidhet me mosplotësimin e kriterit të përcaktuar në pikën “c” të nenit 21 të ligjit 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.	E plotë	Nuk ka
13.	03.05.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi XH.B(student në Turqi) në lidhje me likujdimin e biletave të cilat bëhen 2 herë në vit nga shteti. Si mund ta	11.05.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj, mbërritur në postën elektronike zyrtare të Gardës së Republikës, në të cilën kërkoni informacion mbi likujdimin e biletave të transportit, ju informojmë si më poshtë:	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
		përfitoj këtë likujdim?		<p>Praktika e dërgimit të studentëve në Republikën e Turqisë, për studentët që konkurrojnë dhe përzgjidhen në Gardën e Republikës, rregullohet nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Brendshëm, i dalë për këtë qëllim. Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës, nëpërmjet një urdhri të brendshëm, përcakton modalitetet e dërgimit të studentëve për studime, i cili ndër të tjera përfshin edhe mundësinë e pagesës së shpenzimeve të udhëtimit.</p> <p>Në rastin tuaj, rezulton se praktika për mundësimin e ndjekjes së studimeve në Republikën e Turqisë është iniciuar nga Ministria e Brendshme, në periudhën tetor-nëntor 2020. Në lidhje me sa kërkoni, sugjerojmë t'i drejtoheni Ministrisë së Brendshme për të përfutur informacionin e nevojshëm.</p>		
14.	06.05.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi A.Xh, për të aplikuar për punë në Gardën e Republikës.	08.05.2023	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se Garda e Republikës është një institucion i administratës shtetërore dhe funksionon bazuar në ligjin 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Referuar misionit, ai lidhet me garantimin e sigurisë së personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje, mision i cili nuk ndryshon në gjendje të fatkeqësisë natyrore, të jashtëzakonshme apo në gjendje lufte. Sa i përket kërkesës suaj, Garda e Republikës nuk është kompetente për sigurimin e subjekteve, për të cilët ju interesoheni.</p> <p>Për më tepër informacione rreth Gardës së Republikës dhe veprimtarisë së saj, ju ftojme të vizitoni faqen zyrtare www.garda.gov.al.</p>	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
15.	08.06.2023	Kërkesë nga shtetasi M.SH për tu bërë pjesë e Gardës	09.06.2023	Aplikimi për punësim në Gardën e Republikës bëhet kur shpallen vende të lira pune. Aktualisht ne sapo kemi mbyllur një proces rekrutimi për ish ushtarakët, që dëshirojnë të punojnë në gardë. Për informacion ju lutem ndiqni periodikisht njoftimet në adresën www.garda.gov.al	E plotë	Nuk ka
16.	21.06.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi A.K, për të ditur se çfarë është bërë me dokumentat që ka dorëzuar?	22.06.2023	Garda e Republikës ka shpallur vende të lira pune, për ish ushtarakët, në muajin Mars 2023, ku pas procesit të verifikimit dhe testimit janë përzgjedhur kandidatët për punësim. Ju nuk keni aplikuar sipas mbas njoftimit të bërë nga ana jonë, për dokumentacionin dhe afatet e aplikimit. Në vijimësi do të ketë përsëri njoftime dhe ju mund të riaplikoni. Është e rëndësishme që të paraqisni kërkesën duke u bazuar në kriteret e shpallura në njoftim	E plotë	Nuk ka
17.	26.06.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi A.B, për të ditur se kur rihapen aplikimet për tu bërë pjesë e institucionit.	26.06.2023	Ju mund të aplikoni për punësim në Gardën e Republikës, në çdo kohë që ka njoftime punësimi, nëqoftëse plotësoni kriteret ligjore të shpallura në njoftimin e punësimit.	E plotë	Nuk ka
18.	05.07.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi E.M për të ditur një përgjigje në lidhje me aplikimin që ka bërë pranë institucionit .	07.07.2023	Aplikimet për punë në Gardën e Republikës bëhen kur institucioni shpall vende të lira dhe në këto raste njoftohen edhe për afatet e dorëzimit të dokumenteve dhe të testimit. Aktualisht ne nuk kemi bërë njoftim për aplikim. Gjithsesi kërkesa juaj është administruar dhe do tju njoftojmë kur të ketë shpallje për konkurim.	E plotë	Nuk ka
19.	07.07.2023	Kërkesë nga shtetasi E.R për tu bërë pjesë e Gardës.	07.07.2023	Aplikimet për punë në Gardën e Republikës bëhen kur institucioni shpall vende të lira dhe në këto raste njoftohen edhe afatet e	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
				dorëzimit të dokumenteve dhe të testimiit. Aktualisht ne nuk kemi bërë njoftim për aplikim. Gjithsesi kërkesa juaj është administruar dhe do tju njoftojmë kur të ketë shpallje për konkurim.		
20	16.07.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi A.S në lidhje me rrugën që duhet të ndjek për të aplikuar për punë në pozicionin vakant .	18.07.2023	<p>Punësimi në Gardën e Republikës bëhet bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 33/2021 "PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", i cili në nenin 21 përcakton: Kriteret e pranimit</p> <p>1. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasit në Gardë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) të jetë shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë; ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm; d) të jetë i moshës 19-30 vjeç; dh) të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që, sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë; e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi a kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje; ë) të mos jetë në ndjekje penale; f) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore; g) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike vendim gjyqësor të formës së prerë. <p>2. Në nivelin bazë, shtetasi pranohet si punonjës i Gardës së Republikës, kur, krahas plotësimit të kriterëve të përgjithshme, ka përfunduar edhe arsimimin për rolin bazë për punonjës të Gardës në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit/ministrisë përgjegjëse</p>		

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
				<p>për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.</p> <p>3. Bazuar në nevojat e identifikuar për rekrutimin e punonjësve të nivelit të mesëm, në Gardën e Republikës pranohen edhe shtetas që kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve të arsimit të lartë dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Pas përfundimit të kursit të formimit profesional, u jepet grada “nënkomisar”.</p> <p>4. Pranohet si punonjës i Gardës së Republikës edhe shtetasi që ka përfunduar arsimin përkatës në institucionet arsimore homologe jashtë vendit të njësuara me programet e institucionit arsimor të Policisë së Shtetit, Xhandarmërisë, Karabinierisë, Gardës Civile orukturave të tjera të njësuara me to dhe që diplomat e tyre janë njohur dhe ekuivalentuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>5. Të gjithë kandidatët fitues, pas emërimit në detyrë, ndjekin programin e profilizimit të përcaktuar në politikat e arsimit të Gardës së Republikës.</p> <p>Për kohën e aplikimit duhet të ndiqni njoftimet në faqen zyrtare të gardës www.garda.gov.al</p>		
21.	26.07.2023	Kërkesë për informacion nga shtetësja D.M, për të bërë rezervimin e Pallatit të Brigadave, për të bërë foto dhe videoklipin e dasmës.	27.07.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare është institucioni që administron Pallatin e Brigadave, të cilit mund t’i drejtoheni për informacion në lidhje me sa kërkoni. Garda e Republikës, në zbatim të akteve nënligjore, është institucioni që ruan e siguron Pallatin e Brigadave por nuk mund t’ju sigurojë informacionin e kërkuar.	E plotë	Nuk ka
22.	24.07.2023 25.07.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi XH.B(student në Turqi) në lidhje me		Në përgjigje të kërkesës suaj, mbërritur në postën elektronike zyrtare të Gardës së Republikës, në datën 25 Korrik, në të cilën	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
		likujdimin e biletave të cilat bëhen 2 herë në vit nga shteti. Si mund ta përfitoj këtë likujdim?		<p>kërkoni informacion mbi rimbursimin e biletave, kërkesë e përsëritur së cilës i jemi përgjigjur edhe më herët, ju informojmë si më poshtë:</p> <p>Praktika e dërgimit të studentëve në Republikën e Turqisë, për studentët që konkurrojnë dhe përzgjidhen në Gardën e Republikës, rregullohet nëpërmjet Urdhrit të Ministrit të Brendshëm, i dalë për këtë qëllim. Bazuar në Urdhrin e Ministrit të Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës, nëpërmjet një urdhri të brendshëm, përcakton modalitetet e dërgimit të studentëve për studime, i cili ndër të tjera përfshin edhe mundësinë e pagesës së shpenzimeve të udhëtimit.</p> <p>Në rastin tuaj, rezulton se praktika për mundësimin e ndjekjes së studimeve në Republikën e Turqisë është iniciuar nga Ministria e Brendshme, në periudhën tetor-nëntor 2020. Në lidhje me sa kërkoni, sugjerojmë t'i drejtoheni Ministrisë së Brendshme për të përftuar informacionin e nevojshëm.</p>		
23.	04.08.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi E.D në lidhje me rrugën që duhet të ndjek për të aplikuar për punë në pozicionin vakant	07.08.2023	<p>Për tu pranuar në Gardën e Republikës duhet të nënshtroni konkurrimit dhe më pas kursit të kualifikimit në Akademinë e Sigurisë. Kjo ndodh kur të shpallet njoftimi për vende të lira pune. Aktualisht nuk kemi njoftuar për aplikime.</p> <p>Për njoftime ndiqni faqen e internetit www.garda.gov.al</p>	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
24.	30.08.2023	Kërkesë për punsim nga shtetasi F.L	30.08.2023	<p>Punësimi në Gardën e Republikës bëhet, bazuar në ligjin 33/2021 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë" i cili në nenin 21 përcakton kriteret e pranimit;</p> <p>Neni 21 Kriteret e pranimit</p> <p>1. Kriteret e përgjithshme të pranimit të shtetasit në Gardë janë:</p> <p>a) të jetë shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë; ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm; d) të jetë i moshës 19-30 vjeç; dh) të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që, sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë; e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje; ë) të mos jetë në ndjekje penale; f) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore; g) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.</p>	E plotë	Nuk ka
25	13.09.2023	Kërkesë për punsim nga shtetasi K.A.	13.09.2023	Ju mund të aplikoni për punësim në Gardën e Republikës, kur të shpallen vende të lira. Për këtë, ju lutem ndiqni njoftimet në adresën www.garda.gov.al , në rubrikën, njoftime për publikun.	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
26.	15.09.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi M.C në lidhje me datat e rekurimit.	18.09.2023	Aplikimet për pranimet e reja në Gardën e Republikës kanë filluar. Për më shumë informacion klikoni në link më poshtë: Njoftime për publikun Garda e Republikës së Shqipërisë	E plotë	Nuk ka
27.	19.09.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi A.C nëse ka mundësi për të riaplikuar përsëri për pozicionet vakante në Gardën e Republikës.	19.09.2023	Sipas njoftimit të shpallur në faqen zyrtare të Gardës së Republikës, janë shpallur 50 vende vakante për punonjës të nivelit bazë. Çdo kandidat i interesuar, i cili plotëson kriteret e përcaktuara ligjore, është i lutur të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 20 Tetor 2023, në adresën postare: Garda e Republikës së Shqipërisë, Rr. Elbasanit, pranë Pallatit të Brigadave, Tiranë. Aplikanti që nuk plotëson qoftë edhe një prej kriterëve të përcaktuara, nuk kualifikohet për të vijuar konkurrimin e mëtejshëm.	E plotë	Nuk ka
28.	23.09.23 25.09.2023 Me nr.prot 1994	Kërkesë për informacion nga shtetasi A.M, në lidhje me aplikim e bërë për pozicionet vakante , pasi i vetmi kriter që nuk plotëson është mosha.	09.10.2023	Në përgjigje të kërkesës tuaj lidhur me kriteret e punësimit në Gardën e Republikës ju informoj se kriteri i moshës është i bazuar në nenin 21 të ligjit nr 33/2021 "Për Gardën e Republikës". Për më shumë informacion për aplikimet, ju lutem klikoni në link më poshtë: SHTATOR-2023-VENDE-TË-LIRA-PËR-PUNONJËS-TË-NIVELIT-BAZË-NË-GARDËN-E-REPUBLIKËS.pdf (garda.gov.al)	E plotë	Nuk ka
29.	27.09.2023	Kërkesë për informacion nga shtetësja B.M për mundësi punësimi pranë strukturave të Gardës?	29.09.2023	Punësimi në Gardën e Republikës bëhet nëpërmjet konkurimit, kur shpallen vende të lira. Për më shumë informacion, ju lutem ndiqni njoftimet e punësimit në faqen zyrtare të institucionit www.garda.gov.al	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
30.	16.10.2023	Kërkesë për informacion nga shtetasi A.C, për mundësi punësimi pranë strukturave të Gardës.	17.10.2023	Ju mund të aplikoni për punësim në Gardën e Republikës, kur institucioni të shpallë vende të lira dhe të kërkojë të punësojë ish ushtarak, sikurse jeni ju. Aktualisht kemi shpallur vende të lira për të punonjës që pranohen rishtas dhe që do të ndjekin Akademinë e Sigurisë. Për më shumë informacion mund të ndiqni njoftimet në faqen www.garda.gov.al	E plotë	Nuk ka
31.	28.10.2023	Kërkesë për informacion nga A.N. për koston e realizimit të disa fotove ne pallatin e brigadave dhe perdorimin e hapsirave?	30.10.2023	Përsëritet, Në përgjigje të kërkesës suaj, ju informojmë se referuar dispozitave ligjore e nënligjore që normojnë veprimtarinë e Gardës së Republikës, Pallati i Brigadave ruhet dhe mbrohet nga institucioni por nuk administrohet nga Garda. Duke ju falenderuar, Garda e Republikës	E plotë	Nuk ka
32.	03.11.2023	Kërkesë për informacion nga I.M -A e mbron/ruan/shoqëron Garda e Republikës shtetasin S.B? -Nëse po sa Gardistë të Gardës së Republikës e ruajnë/mbrojnë/ shoqërojnë Shtetasin S.B?	6.11.2023	I nderuar zoti M., Në përgjigje të e mailit tuaj datë 3.11.2023 “Kërkesë për informacion”, drejtuar Gardës së Republikës, ju bëjë me dije se Garda e Republikës nuk e ruan/mbron shtetasin S.B.	E plotë	Nuk ka
33.	6.11.2023	Kërkesë për informacion në lidhje me afatin kohor se kur mund të hapen sërish aplikimet për punësim në Gardën e Republikës.	6.11.2023	Përsëritet zoti C., Ne sapo kemi përmbyllur një proces konkurimi për punonjës të Gardës së Republikës dhe në datën 1 Nëntor, fituesit kanë filluar trajnimin profesional në Akademinë e Sigurisë.	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës ¹	Objekti i kërkesës ²	Data e përgjigjes ³	Përgjigje ⁴	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁵	Tarifa ⁶
				<p>Ju mund të qëndroni në kontakt dhe kur të hapen prapë aplikimet të dërgoni dokumentet sipas ligjit. Shpresoj që njoftimi i ardhshëm të jetë afër dhe ne do tju njoftojmë për tu paraqitur.</p> <p>Faleminderit që na keni shkruar.</p>		
Për muajin dhjetor nuk ka patur kërkesa për informacion						